

INTERVISTË ME ENVER TALIN

Prishtinë | Data: 3 tetor, 2015

Kohëzgjatja: 153 minuta

Të pranishëm:

- Enver Tali (I intervistuari)
- Lura Limani (Intervistuesja)
- Kaltrina Krasniqi (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale të japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Pjesa e Parë

Lura Limani: Zotni Enver, a po na tregoni pak për fëmëminë e juaj, ku jeni lindë, kur jeni lindë edhe pak për babën, nanën edhe kujtimet e fëmënisë së hershme?

Enver Tali: Fëmënia ime ka qenë pak e randë për shkak t'kohëve se jo pse dikush m'ka mundu, po kohnat m'kanë mundu. Sikur krejt shqiptarët, unë kam përjetu edhe Luftën e Dytë Botnore. Luftën e Dytë Botnore kam qenë nxanës i klasës t'tretë i shkollës fillore në gjuhën serbishte. Manej, filloi Lufta e Dytë Botnore, n'atë kohë Italia erdhi n'Kosovë edhe në këto viset tona. Edhe, ai i hapi shkollat shqipe edhe administratën shqipe, shkollën shqipe, kështu që unë fillova vitin e tretë se ajo meti n'gjysë prej Luftës n'serbisht fillova vitin e tretë përsëri me e vazhdu në gjuhën shqipe.

Baba im ka qenë, për kohën e vet një intelektual i madh, administrator i njoftun. Nji shkollë t'kryme n'atë kohë, n'kohën e tij në Greqi, n'Selanik. Edhe ka qenë administrator shumë i kërkumë. E dinte m'u shërby edhe n'familje, dinte m'u shërby edhe botën jashta familjes. Kishte nji autoritet bukur t'mirë për kohën e vet. Por, nuk u arrestu, nuk u ipte ai mas partive, mas kështu, se kishte përvojë t'keqe. Mu ma kishin helmu axhën, vllaun e babës për shkak se paska qenë anëtar i Partisë Komuniste, jo para Luftë, po shumë para Luftë. Edhe ai kishte qenë farmacist teknik, mirëpo farmacist teknik nuk ka pasë n'atë kohë, po farmacist, osht trajtu si farmacist.

Në nji ngatërresë të shtetit n'atë kohë, në të vërtetë me ramjen e Partisë Komuniste në ilegalitet n'atë kohë me 1920-shin a 21-shin, edhe ky bjen - axha po mendoj- n'ilegalitet bashkë me nji mjek doktor Perrën n'atë kohë. Se s'paska pasë komunist tjerë n'rrethin e Gjilanit, po doktor Perra edhe ky t'ndjekun. Edhe doktor Perra ka ikë edhe ky ka ikë n'Kumanovë si mjeshtër i barnave, si farmacuet [farmacist]. E kishte angazhu nji serb maqedon, ku di unë, n'atë kohë maqedonë s'ka pasë, po serbë. Edhe e kishte angazhue me punu në ni farma... si farmacuet [farmacist] në nji farmaci, por farmacia n'podrum se tinëz po punohet. N'atë kohë, n'atë farë lloj podrumi, natyrisht mas tri vjete, ftofet ky, merr ndezje t'mushkërive. Ndezja e mushkërive n'atë kohë ka qenë shumë e rrezikshme. Edhe si i tillëe bijnë n'Gjilan n'familje. N'familje e kem pasë, edhe une e kom mrri atë mjekun serb n'atë kohë, ka qenë baba i nji futbolleri që ju

s'e njifni, Miçës Apotekarit i thojshin se edhe ai mirë ishte me farmaci. Ai n'vënd që me shëru, e helmon. E helmon, kështu që axha m'ka shku i helmum, po pa guxu me e përmend një gjë t'tillë.

E kjo familje po thomë ka vujtë. Baba jem ka qenë administrator n'atë kohë, administrator shumë i kërkumë. Aq i kërkumë që advokatët e asaj kohe e merrshin te ata me punu, sesa me punu n'shtet, pagujshin mirë. Edhe, mrrin Lufta e Dytë Botnore n'atë kohë e baba ndahet, advokaturë s'ka, advokatë nuk ka n'atë kohë edhe baba fillon me u marrë me tregti. Tregtia kryesore n'atë kohë n'Gjilan, po edhe n'Kosovë edhe n'Shipni, se Kosova u bashku me Shipninë, edhe n'Shkodër, kishte nevojë për duhon. N'rrethin e Gjilanit u punonte duhoni me t'madhe. E baba e mlidhte duhonin kështu e çonte n'Shkodër. E kështu që, mundësitë materiale i kishte shumë ma mirë se çdo herë n'atë kohë. Deri në këtë luftë e fundit t'Luftës Dytë Botnore që hynë partizanët çetnikë n'Kosovë, natyrisht edhe n'Gjilan.

N'atë kohë, partizanët çetnikë, natyrisht unë 12 vjeçar hala pa i mushë, klasën e tretë e kryjta n'kohën e Shipnisë. Po du t'them se n'atë kohë unë dhetë vjet e gjysë kisha në... kur hynë partizanët, njëmbëdhjetë pa i mushë. Vazhdova shkollën shqipe, shqip nuk dijsa, shqipen n'qytete nuk u folke shqip, por turqisht. Mirëpo, shumë shpejt e përvetësova shqipen për shkak se gjyshi jem nuk dinte turqisht. Nana, baba natyrisht dinte turqisht, po gjyshi jem nuk dinte turqisht. Po du t'thomë që shumë shpejt e përvetësova gjuhën shqipe, n'shkollë kisha sukses edhe e kryjta klasën e pestë fillore n'atë kohë. Me klasën e pestë fillore, u deshte pesë klasë me i pasë për m'u regjistru n'gjimnaz.

Gjimnazi ekzistonte n'kohën e Shipnisë, kto t'mirremi vesh, ekzistonte vetëm n'Prishtinë. Gjimnazi "Sami Frashëri" edhe n'atë kohë osht' qujtë. Këta e kanë marrë emnin "Sami Frashëri" prej asaj kohe. E kisha kry klasën e pestë, kisha t'drejtë m'u regjistru n'klasën e parë n'gjimnaz. Mirëpo, në '44-shin, n'mbarim të '43-shit, në '44-shin sa ishte ajo... po...

Lura Limani: Në '44.

Enver Tali: Në '44-shin hinën çetnikët partizanë. Edhe me hymjen e tyne nja dy mujë ditë, heshtën ata, ishin t'qetë. Derisa u organizunë edhe bonë planet e veta për se si do t'vepronin shqiptarët. Planet e tyne ishte m'i ngacmu ata pak, me i çu kokat, t'kenë arsye me thanë se ata na sulmunë. E kështu që, krejt njerëzit e asaj kohe ishin edhe fshatarë edhe qytetarët ishin nëpër malet e Kosovës, t'them Gollakut n'atë kohë se Gollaku ishte me Gjilanin i lidhun.

Në atë kohë kur veç njerëzit që gjindeshin n'mal, këta u organizunë n'qytete me bo masakra, masakra me bo. Çka t'mujnë me mrrri, fëmi e pleqë, gra e... se ata që ishin n'luftë, ata ishin... ata që ishin t'rritun e t'aftë për luftë, ishin n'mal, nuk guxojsin me ra n'dorë të këtyne.

Thojsha unë, ato ngatërresat që mujshin këta me kriju dulën n'shesh ma vonë se baba im nuk osht' përzi n'politikë, po mendoj në këto partitë e asaj kohe. Edhe, axha po, axha tjetër, axha ma i ri se baba, ky axha që diq ishte ma i ri se baba. Ky ma i ri se baba, Babushi, ai mirrte pjesë n'këtë Lëvizjen Komuniste t'asaj kohe. Mirëpo, një ditë prej ditëve mas tre mujë dite që hynë partizanët, i mledhën t'rijtë e t'vjetrit, u

mushën burgjet, ashtu venet ku kish mundësi me çelë. Zyret që i kishin, i bonë burgje, i mushën burgjet, ato zyret me t'burgosun pa kurrnifar lidhje, pa kurrnifar vendimi.

Prej atyne s'kishin ku me çu tjetër, baba ishte, axhën e kishin marrë edhe këto që ishin n'lëvizje, edhe baba, axha e kishte pa se çka osht' marifeti i kësaj lëvizjes komuniste të Serbisë. Edhe u tërhoq ai, menjihere aty për aty mo iku prej Gjilanit, shkoi n'Prishtinë. Zeqeria Rexha atëherë ishte një përfaqësues i arsimit shqiptar, e çoi mësus n'Kaçanik. Baba u burgos, e majtën disa ditë, s'kishin vend për burgosun tjetër, gjysën e atyne t'burgosurve i lëshunë për me marrë burgosun t'ri, e aty ishte edhe baba.

Baba erdh n'shpi po shumë i lodhun edhe i mërzitshëm. Ai nuk ka qenë i aftë me ikë e me bo, me bo, me nejtë nëpër male e ku ta di unë. Mirëpo, i punoi fati, një preshevar i vjetër vjen me... Abdullah Presheven nuk e di ju a e keni ndi. Abdullah Presheva ka qenë një prej anëtarëve të partisë që ka vujtë kombi i Shqipërisë. Unë e kam pa, unë si fëmi, jo vetëm unë po shkojshim me pa se si e bijshin Abdullahun prej burgut e nxirrshin, e bijshin, e ulshin me njëfar dërrase me pushu, ai s'kishte mundësi me shëtitë kur i lëshojshin gjoja me shëtitë t'burgosunit bashkë.

(Kollitet) M'falni për... Edhe kishte ardhë miku i Avdullahit që e kishte ndihmu gjatë luftës Abdullahin për me nxjerrë prej burgut, e kishte nxjerrë prej burgut me pare, me t'njoftun edhe e kishte majtë Abdullahun pesë mujë n'shtëpinë e vet derisa u shnohtë u forcu. Manej Abdullahi dulë n'mal kah Presheva anena, edhe ishte i njoftun Abdullahi që çdokush nuk guxojke me u afri me bisedu me Abdullahin kundra shqiptarëve. E Abdullahi e çon këtë njeri t'provumë, e kishte majtë edhe Abdullahin ky njeri, "Shko kqyre çfare osht' gjendja n'Kosovë".

A n'Kosovë kishin fillu me pre e me vra, me vra... ajo ishte puna shumë e lehtë për çdo shqiptar. Mirëpo, ato u përdorshin metoda të ndryshme t'masakrimit, po e zomë Esat Berishën e kanë pasë pre krejt krahnorin {përshkruan me dorë} edhe i kanë pas qitë zjarm hala pa vdekë ai, hala gjallë po pa vetëdije. I kanë qitë zjarm se e ndizshin dru për t'burgosun n'koftorr, u bojke, u bojke si i thojnë zjarri sa s'dihet, e me ato lopata t'mëdhaja i qitshin njerëzve, n'këtë mënyrë i mytshin.

Babën e Jusufit kush e njeh, një inxhinier, osht' ashtu hala gjallë. Babën e tij, unë e di atë vend e kom pa, fëmi e kom pa ku e kanë qitë përmbi dërrasë t'gurit edhe masi e kanë rrehë e kanë mundu e kanë bo llom, e kanë pre n'stomak ato e i kanë qitë zjarm. Metoda t'ndryshme kanë përdorë për me i masakru shqiptarët, edhe jo për me i [masakru], po i kanë masakru shqiptarët.

Baba, ky që erdhi prej Presheve, babën e njifte se shumëkushi e njifte babën në rrethinën e Preshevës e Gjilanit se ishte i kufizumë ai me njerëz. Masanej, Gilani ishte qendër e Gollakut, e Karadakut, e... kështu që babën ai e njifte mirë dhe kishte punu ai, kishte ardhë prej Presheve n'atë kohë, kishte ikë prej bullgarëve, kishte ardhë n'Gjilan dhe ka punu n'Gjilan, e njifte mirë babën. Edhe thotë, "Unë kom ardhë, m'ka çu Abdullahi me pa si osht' gjendjen n'Gjilan me pytë". Ky i thotë Rexhepaj, "Rexhep," thotë, "kërkushi nuk mundet me t'tregu ty se si asht' gjendja n'Kosovë, po ti t'shkojsh te komandanti për mbrojtjen popullore". Ajo kohë komanda e mbrojtjes popullore përfshinte me kah krejt edhe zanatiitë që punojshin, ishin në

komandën e mbrojtjes popullore. Te ai komandanti, komandantin e njëjste edhe baba, edhe ky, se ishte i Tankosiçit afër Pozharanit ai komandantit.

Lura Limani: Thujeni emrin edhe një herë.

Enver Tali: Emrin, s'po m'kujtohet, e kam ditë shumë mirë po s'po m'kujtohet. U mundova m'i gjetë këto me emna po... thotë, "Edhe t'i thushë që t'ka çu Abdullahi me m'kërku mue pse s'ka njerëz t'kalemit që munden me majtë administratën e komunës t'Preshevës n'atë kohë". Ky edhe shkon te ai, thotë "M'ka çu Abdullahi p'e lypë Hysen Talin". Hysen e kishte emrin baba im, "Hysen Talin" thotë, "m'i ia majtë administratën atje n'Preshevë".

Asnjë... se emën kishte Abdullahi, asnjë as dy, e thërret një përcjellës që do ta çon n'Preshevë, me kali me përcjellës, baba shkon n'Preshevë. As që shifet me Abdullahin, as që shkon m'u pa me Abdullahin, mos t'ngatërrojë punët, "Mos t'ngatërroj punët e Abdullahit" thotë ai. Edhe, nejtë, kish nejtë 15 ditë në Preshevë, prej atyhit ka shku te kushërijtë në Shkup. Ne i kem pasë kushërijtë në Shkup. Kushërijtë kanë qenë t'njoftun edhe ata n'Shkup. Ermira Tali, ashtu e... ata e kanë pasë mbiemnin e gjyshit t'vet, Ermira kushi ke ajo, edhe sot përmendet ajo Ermira. Ka qenë anëtare e Komitetit të Maqedonisë, person shumë i... ka pasë magjistru n'Amerikë, tash o' ka doktoron n'Amerikë.

Edhe, ashtu... A baba shkon te axhallarët e vet. Axhën e vet Selimin e kishte n'Shkup, Selimi e kishte Mehmet Alinë djalë. Mehmet Aliu ka qenë shumë ashtu i gjindshëm me tregti, materialisht ka qëndru mirë.

Po, edhe n'Shkup nejtë gjashtë mujë. Prej Shkupit, zavendës kryetari i Maqedonisë ka qenë shkrimtar, Qemal kushi ishte, mbiemnin, ai ishte zavendës i kryetarit. Zavendësin e kryetarit e kishte njoftë baba. Mirëpo, me shumë... trazu... kryetarin e Maqedonisë, nuk ka dashtë me... mos m'i sjellë ndonji telash atij. Pret deri në ni konkurs, n'atë kohë konkurset çfare kanë qenë, nuk e di, kërkojnë, kërkojnë e Shipnia kërkon ekspert të duhanit edhe lajmrohet ky... Duhani asht' punu me t'madhe n'Gjilan, edhe lajmrohet ky thotë, "Unë jam ekspert i duhanit", poshtë e naltë. S'e pranojnë... jo pse si ekspert, po s'e pranojnë ngase, "Ka kush pranohet këtu! Ju jeni t'aftë për me ekzistu", poshtë e naltë, edhe s'e pranojnë.

Mas tre mujve, përsëri një konkurs të tillë... kryetari i Maqedonisë n'terren dikun, nënkryetari ai shqiptari aty, ky shkon te ai. Thotë, atij i tregon hallet drejtë ashtu qysh jonë, "M'u kthy n'Gjilan s'kom mundësi se kanë vra shumë e m'presin edhe mu... me ma mundësu me shku n'Shipni". Cërvenkovski i Maqedonisë n'atë kohë ka qenë ministër i punëve t'brendshme. Ky e thërret Cërvenkovskin, ky shqiptari jonë i thotë, "Po ta lëshoj një njeri m'i dhanë leje me kalu n'Shipni për punë t'veta". Ky s'guxon me ia kthy se ai nënkryetar, kryeministër. Edhe ia jep një leje të cilën e kom pa edhe e kom lexu – "Bez prava povratka" - "Pa leje të kthimit" mo në Kosovë e Shipni. N'Shipni në të vërtetë s'ishte, po n'Kosovë.

Ma vonë mbeti n'Shipni, punoi n'Shipni edhe vdiq n'Shipni. Për atë... derisa ishte n'atë kohë, ka një here katër mujë gati kur u hallakat se u prish, shkoi Rankoviçi e ku di unë. N'atë periudhë ka ardhë n'Kosovë ka

nejtë njo katër mujë edhe e njëfishin, t'gjithë e njëfishin ata t'vjetrit. E ka kalu shumë bukur. Kur u kthy prej Kosovës, mas një kohe shumë t'shkurtë, baba diq. Kështu që, meta edhe pa babë.

Lura Limani: Kur ka dekë ai?

Enver Tali: Baba ka vdekë m'duket n'vitet... n'vitin '80, nuk e di me saktësi, po përafërsisht po thomë në '81-shin diq. Edhe meta edhe pa babë po du me thanë. Unë isha n'Prishtinë, n'Prishtinë kisha regjistru, si fëmi që kisha kry shkollën fillore, edhe dojsa me vazhdu shkollën. Po, kom pasë një zullum tjetër.

Pjesa e Dytë

Enver Tali: Kish kohë për m'u rritë e me përjetu vdekjen e babës, edhe pse ai ishte n'Shipni. Me 20 dhjetor 1944, asht' bo një luftë mrena n'qytet, Lufta e Gjilanit e njoftun, edhe aty jonë bo masakra t'mëdhaja me fëmi e me t'sëmutë e me pleq, që krejt çka kanë mri. N'atë luftë ma vrajtën gjyshën.

Lura Limani: Gjyshën?

Enver Tali: Po, ma vrajtën edhe babgjyshin. Fëmija me nanën time kishin ikë në një shtëpi të kojshisë, gjoja ma, n'Shtruhërë [fshat në Vushtrri], banesë ma e sigurtë e t'kojshive natyrisht. Edhe, ata dytë kishin metë n'shpi. Kishin hi serbët edhe ata i kanë gjetë, ata i kanë vra, gjyshen ma kanë lanë n'oborr t'vramë n'oborr t'shpisë. Babgjyshin ma kanë qitë jashtë oborrit t'shpisë, aty kalonte një përrockë e ujit, e kishin qitë n'përrockë aty.

Erdh një plakë, një plakë tjetër e kojshive, "Shuni, shuni, shuni", thotë, "se fillunë njerëzit m'u vra". Ajo kishte pa vrasjen e gjyshes teme edhe gjyshit tim, se e kufizume as pa dalë. "Kon e kanë vra?" thotë, "Adile kadin, Adil kadin". Do t'thotë Adilja ishte emni i gjyshes teme, e Adilekadën n'atë kohë u përdorke ajo fjala kadën¹. "Adile kadën po, edhe agën Tal po". Gjyshi e kishte emrin Myftar, mirëpo sikur që e kem zakon me i shkurtu emnat e ma i ndërru emnat, kërkush s'e ka thirrë Myftar, po Tal. Tal, Tal, po Tal e kullutë diqysh nuk i binte fjala, atëhere ia kanë ngjitë aga Tal.

Pra, çdokush e njëfte, edhe n'rreth edhe n'qytet edhe çdokush e njëfte si aga Tal. Edhe kjo thotë, "Agën Tal e vrajtën, edhe Adile kadin e vrajtën". Këta të mitë vrapunë mas Adile kadin edhe kështu... unë si fëmi megjithëqë nuk m'lojshin me dalë përjashta, u përbirova edhe mrrina me dalë me pa. Mrrina deri n'oborr, e pash gjyshin t'vramë edhe i thirrën do njerëz aty. E murrëm gjyshin t'vdekun qashtu t'vramë n'baltë, e murrëm e qitëm përmi një, si me thanë, terracë nuk asht' ajo se ishte prej dërrasave edhe aty e shtrimë një here, masanej mrena në një dhomë gjyshen edhe e shtrimë si t'vdekët. Na ikëm përsëri, shkumë te kojshitë.

¹ Turq.: *kadin* – grua, zonjë.

Mirëpo, t'u shku te kojshia, kojshia e kishte një djalë ma t'madh se une për një katër-pesë vjet. "Hajde", thotë, "t'shkojmë na t'mshifemi". Ku mu fsheh? Ata kishin kuaj. E si të tillë kishin pleme me bari t'thatë si i thonë sanë, aty thotë, "Hajde t'shkojmë t'hypim n'pleme e t'hijmë n'sanë". Mirë, unë ma i ri se ai, as nona s'e dinte as kërkush s'e dinte. U çumë, hypëm n'plehme, ai hyni në një qosh në një kand e asaj dhomës, nxurrë bari edhe hyni, n'kambë ashtu, u mshef, do bari e qiti përmi {tregon me dorë sipër kokës}. Unë ato s'mujsha me e bo se isha ma i ri se ai, mledha pak sanë e qita aty, u shtrina, e mlova kokën me sanë, komtë m'kanë metë përjashta.

Kur kanë hy këta për me lypë dikenin s'kanë gjetë atje n'pleme ashtu. M'gjetën mu, po m'ngrehin për komësh, m'murrën mu, m'nxurrën prej atyhit edhe m'qitën n'oborr... n'oborr jo, po n'rrugë. N'stomp të atij përronit kanë pushkatu shumë njerëz, edhe aty ishin nja shtatë a tetë pleqë t'lagjes t'lidhun. I njëfisha unë ata se ishin t'lagjes. Edhe mu m'lidhën me ata pleqë për pushaktim. Tre vetë na rujshin me automata t'rusit asi... mitroloz që lëshohet n'tokë me tri kamë. Edhe, ishin të armatosur deri n'dhamë. Edhe m'lidhën edhe mu, po m'lidhën ashtu n'skaj.

N'atë kohë ka hy, n'Gjilan ka hy një njësi ushatarake të Shaban Haxhisë, Shaban Haxhia, ajo brigadë ka qenë brigadë e Shipnisë. Edhe asht' një pjesë, kanë dalë ata m'i shpëtu njerëzit se kanë marrë vesh që po vriten njerëzit, shqiptarët edhe kanë dalë ashtu grupe-grupe nëpër qytet.

Lura Limani: Një pyetje, këta që ju vërajshin, a ishin partizanët serbë apo bullgarët?

Enver Tali: Serbë. Bullgarët s'kanë vra, s'kanë vra bullgarët, serbë ishin ata krejt. Ata ishin... veç masi ma përkujtove ashtu, ata ishin dy brigada t'formume prej çetnikëve që ishin nxonë peng prej partizanëve gjoja... po një soj ata. Ia kanë hjekë ato kokardat e çetnikëve ia u kanë vu atyne robëve që jonë nxonë, ia kanë dhonë petokrakat. Kokardat hiqi, vnoji petokrakat edhe u bojshin partizanë ata. Ata kanë vepru edhe kanë vra, po natyrisht nën udhëheqësin e komandantëve serbë.

Edhe neve... kanë vra çka kanë vra, edhe neve na erdh reni me na vra. Mirëpo, si t'lidhun ashtu mas shpinës tonë, te ura aty të asaj përrockës, po vijnë partizanët e Shaban Haxhisë. Edhe ata me armë, "Mo luj, mo luj, mo luj!" po piskasin, këta i çunë dur të nalte, "Mo luj, mo luj". I çunë dur të nalte, na kthymë me kqyrë edhe ata petokrakat i kishin, tash qysh m'i besu. Po, nejse deri sa folën shqip, kishim shpresa. Kur erdhën aty, "Çka jonë këta?" "Armiqë". *Neprijatelj* i thojshin ata, "Anmiqë, anmiqë." Unë isha pranë atij udhëheqësit t'grupit aty. Masi m'i kanë pre konopt kta, mu edhe tjerëve, ata tuj i thonë, "Armiqë, armiçë – *neprijatelj*", ai ma mshoi n'krah {i mëshon shpatullës} edhe m'çoi, se unë kom qenë pak i dobët pak prej shnetit. M'çoi pak te nalte, tha, "Edhe ky fëmi, armik a?" Kishte një pistole n'dorë, te tretë i vrajti pa bo zo, ata që na pritshin neve.

I vrajti te tretë, neve na lirinë, dulëm prej atyhit, erdhën edhe ata me neve. Një pjesë e atyne ushtarëve me ne n'atë shtëpi ku ishim, aty flejtën, aty pushunë. Po ndërkohë, u njëjtën një dy rafalla të qartë, ata t'automatit tërë e t'mitroloz e... edhe u folë se edhe ata që kanë dalë tash, se edhe të tjerët kishin dalë me njerëz me pru me neve edhe me lidhë, edhe me i vra edhe ata me neve. Mirëpo, këta i tregunë, këta i

tregunë, ata që ishin me neve t'lidhun, hala kanë prej këtyne që kanë dalë me mledhë njerëz. Këta ishin t'interesumë për atë punën tonën, i kanë nuanë sigurisht. Njo dy rafalla t'gjatë u njiën edhe thanë se këta që erdhën prej Shipnije i likvidunë edhe ata, i vajtën.

Kështu, pështova kokën edhe unë, me do tjerë megjithqë u vranë shumë aty. Para komëve t'mia ishin dy t'vramë që i nji fsha, kojshi t'mi n'rugë, n'qytet e banesë. E plagosën shumë randë një zojë, një kojshikë teme, t'u gjujtë me automat me vra, e plagosën. Dy ditë fëminë e kishte, po një vajzë e kishte. Edhe, thanë që e vajtën, e vajtën, mirëpo masanej dul se ajo asht' gjallë hala, ka duru edhe dy ditë e ka vdekë. Ajo çika u rrit (buzëqeshë). U rrit çika dhe u mar... e plagosën, ato plumba e kishin kapë dikun {prek këmbën}, ia kishin gërrithë themrën e kamës, edhe ajo me atë gërrithje u deshtë me çalu për me mujtë me ecë. U martu n'Shkup ajo, boni fëmi e krijoi familje. Kështu kanë hekë këta njerëz tonë n'atë kohë, po mendoj shqiptarët n'përgjithësi.

Lura Limani: E tani kur keni shku ju n'shkollë n'Prishtinë?

Enver Tali: Eh tash po ju tregoj, vijmë deri te ajo. Mbas asaj lufte, nana që nuk m'linte me flejtë me gjyshen se edhe unë isha qejf me flejtë me gjyshen, edhe ajo gjyshja kishte qejf me flejtë me mu. Nana s'më lëshonte, thonte, "Jo, me ra bomba atje te unë, ky mbetet jetim. Me ra te ai, unë jes pa djalë". N'këtë mënyrë e spjegonte vetes ajo edhe s'më lëshonte me shku as me gjyshen me flejtë. Mirëpo, në ato situata në të cilat ishim, na kanë plaçkitë n'katër anët. S'kishin lanë gjo pa marrë n'atë shpinë teme. Bile, bile, atë matësin e korrentit si i thonë asaj, edhe ato e kanë nxerrë prej vendit, mirëpo s'e kanë kputë prej kabllave, e ajo ka metë i varun ashtu s'e kanë marrë.

Edhe ka mbetë, n'rugë e kishin lonë te dera e oborrit sandukun e pajës, çejzit të motrës teme, për mu kthy me marrë masnej. Mirëpo, këta mrrinën përpara këta tanët, e murrën atë sandëk, s'kish metë gjo tjetër, edhe e shpëtunë. Qat sënduk e shpëtunë se tjetër kurgjo jo. Mirëpo, kojshitë na dhanë, shërby me jorgana, me dysheka, kështu që nuk kemi hekë keq.

Unë mbeta njo 14-15 ditë aty, n'atë kohë erdhi një partizane e njoftun në atë pjesë t'qytetit, Behija. Ajo ishte, ajo ishte ashtu jo serbe, jo edhe shqiptare, po boshnjake, e bija e myftisë që ai myfti ka qenë n'Gjilan.

N'Gjilan ka shërby si myfti edhe e kishte... përveç familjes që e kishte katër antarë, kishte Behinë, ashtu. Po kur u bo që hynë shqiptarët, Shipnia erdhi, ata ikën, shkunë për Bosne. Edhe kjo ishte dashunu në një kojshi tonin aty edhe mbeti për hatër t'tij, Vesel Rexhepi ishte ai. Edhe, kështu që ajo mbeti, ashtu si pjesëmarrëse e luftës, Veseli ishte pjesëmarrës i luftës, edhe kjo pjesëmarrëse e luftës si partizanë e asaj kohe.

Edhe kish ardhë ajo prej Prishtine me marrë armë a municion a, nuk e di si ishte muhabeti. Mirëpo, si kojshi ka ardhë me na vizitu neve. Nana thotë, "Merre Enverin me veti çoje n'Prishtinë". Po e kisha edhe një

motër tjetër ma t'madhe se unë thotë, "Merre Hajrinë", ajo ishte Hajria, motra jeme, merre edhe Hajrinë edhe shpëtoje prej ktuhit. Po ajo, edhe me t'vërtetë na murrë.

Motra m'shkoi me to me një Fiat kerr, mu m'ngarkunë me njëfar kamioni me municion edhe ku unë armë nuk kom pasë aty, me përjashtim të një që e prunën, një t'ri ma t'vjetër se unë n'atë kamion. Ai i kishte pasë do pushkë e sene, po unë municion po, a armë nuk pashë. Nejse, na ngarkunë n'atë far kamioni, u nisëm ne për ashtu. Ishte 21, 22 se 23-shi menjëherë mas luftës, dy javë mas ashtu... po du me thanë se n'fillim të janarit, n'fillim të frorit të '44-shit ne po udhëtojmë për Prishtinë. Unë n'kamion me këtë Rexhepin, ai Rexhep e kishte emrin, ky djali i kojshisë. Faktikisht këta ishin prej Bujanovcit po t'ramë. Bujanovci pat metë, n'kohën e Shipnisë pat metë bullgarëve në Serbi, e ata kanë pasë ardhë në kohë t'Shipnisë n'Gilan.

U nisëm, një kamion OM i madh italian, OM italian, i madh i gjatë, i ngarkumë shumë, mirëpo borë n'rrugë. Edhe borë binte vazhdimisht, kamioni na mbetë n'rrugë. Na mbeti n'rrugë edhe era kishte bajtë si me thonë n'rrugë kishte qitë borë, dhe metë kamioni s'po niset. Tentumë diçka me bo, kurgjo jo. U çumë, në kabinë përveç shoferit ishin edhe tre vetë. Njenin prej tyne e njëfsha, i Llazonëve ka qenë ai, ato e njëfsha. Ata dulën, dulën në kabinë se ftoftë përjashta, neve na lanë n'kamion. Nana m'kishte veshë mirë, fort shumë nuk e kam ni t'ftoftin. Po erdhi nata, kamioni s'po del, këta shkunë, vetëm unë edhe ai Rexhepi i kojshisë, aty metëm. Nirthtëm, nuk nirthtëm, ajo dita.

Para se me agu drita, Rexhepi tha, "Hajde t'hijmë poshtë, ta bojmë një tunel prej bore", me pastru borën, e me hy n'tunel t'borës, "se mos po vijmë këta shkijet këtu". Kërsitën do automata e pushkë e n'Ferizaj me t'madhe. Edhe u tutëm, hajde me hy tash n'atë far tuneli, me hy aty. Hynëm, veç kokën e kishim qitë prej borës, na vet n'borë. T'u kqyrë kah Ferizaji, kah rruga, i dallumë dy njerëz që po vijmë. Po ecin njerëz, po çka jonë tek jonë, nuk e vërejta. T'u ardhë, e vërejtëm se aty ishte një gru me çarshaf, me një burrë. E kur pamë çarshafin, do t'thotë se jonë njerëz tonë, s'rrezikojnë. Dulëm na prej tunelit. "Çka osht' bre?" "Jo, bre këta dreqën e kanë Bozhiqin, kanë qitë për Bozhiq". N'atë far vakti, nejse, kanë qitë, kanë qitë (buzëqeshë). Ata shkunë e na metëm aty. Pak ma vonë erdhën këta përmas kamionit.

Këta na çunë n'Ferizaj. N'Ferizaj na çunë me njëfar shpije, ajo shpi ka qenë kojshi me neve n'Gjilan. Ata na murrën, na ushqynë, na ngrohën, na bonë shumë shërbime që shpëtumë me fjalë tjera. Mirëpo, hala s'po dihet për Prishtinë. Atë natë bujtëm aty se s'erdh kush me na marrë. T'nesërmen kanë organizu 16 penë, ata thojshin se e maj n'mend, kijë, bujë, lopë e çka kanë pasë njerëzit me ngrehë kamionin prej borës. Edhe e kishin ngrehë kamionin prej borës edhe me na marrë neve. Na murrën neve, na ngarkunë n'kamion, a këta motra me këta tjerë kishin thonë se ekspoldu kamioni edhe ka ata kanë maru, kanë dekë.

Motra ish pas... te dyjat besa, se ajo motra tjetër me Behijën me Fiat kerr, kishte m'ri mrena ditës. E këto ishin bo vet e 40-ta qysh na diq vllau, e qysh na... Kur mrrinëm na atje, gëzimi ishte ma i madh sesa idhnimi, edhe kështu që edhe unë u bashkova ashtu, e motrave aty. Mirëpo, n'atë kohë ka qenë, ushqimi i njerëzve ka qenë i kufizumë shumë. E ata që s'punojshin, mirrshin 350 gramë bukë n'dite, 350 gramë bukë

n'dite. Ata që punojshin, mirrshin 400 gramë bukë n'dite. Ne që kemi shku, s'kemi pasë as tre gramë bukë. Po në kafshatën e tyne... nipi jem, ndoshta e njifni Shpend Bajramin, se ka qenë i biri i Zeqir Bajramit. Zeqir Bajrami ka qenë profesor i gjeografisë në ashtu n'gjimnaz e ma vonë edhe n'fakultet. E djali i tij ishte fëmi, ato 300 gramë t'tijna në ashtu na i kanë dhonë neve, mu edhe motrës me ekzistue.

Ky Veseli mas do ditëve, qiky Veseli që na ngarkoi në ashtu... e murrë Behijen faktikisht, edhe na ngarkoi n'kamion. M'shikhe se vijke aty shpesh, m'shikhe mu fëmi, s'kishte ku me m'çu me punu. Dikur vendosin me m'çu, edhe m'çojnë me punu furrëtar. Në një furrë të ni serbi, në furrën e serbit. A don dikush me u mbështetë? {i drejtohet të pranishmëve} Jo (buzëqeshë).

Edhe n'atë furrë m'çoi me punu edhe mu. Furra e asaj kohe ishte shumë vështirë me punu, e kishte atë drunin e gjatë me fshi furrën me harrën. Unë s'mujsha me bo, megjithqë ma pruni ni sandëk që mu çu pak ma naltë, s'mujsha, rondë. M'qiti, ai serbi jo po për inati se i duhshe atij punë. M'qiti, erdha, "M'qiti bre", "Mirë". Erdh Veseli, Veseli e murrë vesh që m'kanë qitë, "Hajde po t'çoj dikund tjetër".

Ibrahim Prepolli ka qenë ashtu zdrukhtar n'atë kohë. Po, zdrukhtaria e tij ishte nën komandën e Narodno Odbranës² edhe kjo furra ishte nën Odbranën. Shkova me punu te Ibrahim Prepolli, dimën, borë, kijamet. Mirëpo ato dërrasat e gjata t'trashja s'un i bajsha, s'un i ngrehsha unë. Edhe Ibrahim i bajti do ditë, edhe ai m'qiti (qeshë). Mirëpo, Veseli s'u nda, kishte gjetë një vend pune, berber edhe m'çoi berber me punu. Aty e kisha mirë se s'kishte kush me ardhë me mu qethë e mu rru n'berberhone, po vijshin qësi far oficiera që kishin marrë ashtu grada gjatë luftës, e kishin pare boll.

Unë shkojsha me një fshisë, me një fërrçe a s'di çka ka qenë. Fshijsha mrapa burrave. M'jepshin ndonji dinarë ashtu edhe boll pare bojsha edhe e kisha ma lehtë. Mandej pagesa ka qenë e njojtë, pagesa ka qenë një zembil³ dy herë n'javë m'jepshin voj e pasul e sheqer e oriz, me qato shkojsha te motra i çojsha. Me qato jom ushqye edhe e kom shpëtu, po mendoj e kom thy urinë. Edhe, këtu tash pritsha, u folke që gjimnazi, do t'çelet gjimnazi. Mas tre mujë ditëve me 15 mars 1945 u çelë gjimnazi real "Sami Frashëri". Atë ditën e parë me 15 mars shkova u regjistruva n'gjimnaz, m'pranunë. Mas një kohe shumë t'shkurtë u çelë edhe internati për nxënës, shkova n'internat me jetën vazhdova n'gjimnaz, n'internat.

Kështu, n'atë jetë mrrina deri n'klasën e katërt n'gjimnaz. Po, n'klasën e katërt n'gjimnaz kem pasë një profesor t'historysë, Gjon Serreqi. Gjon Serreqi osht i njoftun n'atë kohë se këta e kanë pushkatue. Ai kur erdhi n'gjimnaz, lëvrit'te, donte me formu diçka, ka formu n'qytet shumëçka. Edhe, n'gjimnaz kishte formu një grup kundra pushtetit serb t'asaj kohe. Edhe n'atë grup ishin dy, ishin dy që ishin t'njoftun aty. Njeni, i treti ai ishte marrë mrapa qysh s'e kishin shpallë atë Mehmetin, Mehmet Pozharanin.

² Narodna Odbrana ishte grup serb nacionalist krijuar me 8 tetor 1908 si reagim ndaj aneksimit austro-hungarez ndaj Bosnës dhe Hercegovinës. Atëkohë, kishte qëllim mbrojtjen e serbëve etnikë në Austro-Hungari. Për të përmbushur qëllimet, Narodna Odbrana shpërndau propagandë si dhe organizoi forca paramilitare.

³ Zembil, nga turqishtja, trastë.

Mehmet Pozharani ka qenë baba i këtij Ombuspersonit që ndërrunë tash, Sami Kurteshi. Baba i këtij, burrë shumë i mirë, burrë me jashtëzakonisht ideale t'nalta, me drejtësi t'shpiritit. Edhe ai erdh te unë tha, "Kqyre, na kemi diçka nërmend me punu". I kisha n'klasë këta, Ahmet Malishevën, Rexhep Kurteshin edhe Mehmet Pozharanin, Pozharani u thirrte, i kisha n'klasë. Erdhi Mehmeti tha kështu kështu "E kom pasë ndërment, po a ta merr mendja?" Unë n'atë kohë a ta merr mendja që isha mllefosë, këta bërllogat që i kishin bo, domethonë që do t'fitojmë e do t'nxerri hak, "Po more".

Këta t'parët ishin betue në prezencën, në të vërtetë para Gjon Serreqit. Tash une që isha deklarë që ashtu... Ahmet Malishevës. Ahmet Malisheva ishte edhe ai i Gjilanit, edhe ato e kisha pasë n'klasë, kisha kry pesë klasë fillore. Tash ishim t'rritun se ata i murrën prej atyne shkollave të, shkollave fetare, i prunën n'shkollë, i regjistrunë edhe kishin sukses, ata mrrinin, edhe mrrinë, na zunë neve. Edhe Ahmetin e kishim, Ahmet Malishevën e kishim udhëheqës, para tij u deshte m'u, unë m'u betu, a këta ishin betu para Gjon Serreqit. U betova, u bona anëtar. Mirëpo, kërkush s'e dije atë muhabet.

Lura Limani: A ka pasë grupi emër?

Enver Tali: Grupi... tash po vij deri aty. Se, n'atë grup, Rexhep Kurteshi e kishte bindë Ahmetin që duhet me punu edhe një. Ai ka qenë njeri shumë i rrezikshëm, ai [ka] bashkëpunu me drejtin e mallkumë kundër shqiptarëve. Erdhën Rexhepi, tha, "Do ta pranojmë Xhavit Shabanin", edhe ai i Pozharanit. Thashë, "Kon?" "Xhavitin". Thashë, "Jo, kurrë!" Po bohet, s'bohet, Rexhepi me Ahmetin e kishin pranë, por na s'e pranojshim, une edhe Mehmeti s'e pranojshim.

Kur mbaroi viti shkollor me 30 maj, jo qershor ishte... maj, maj, maj... po, na si maturanta shkumë n'pushim 15 ditë me përgatitë semimaturën, provimin e semimaturës. Atë natë që e marumë, atë ditë që e marumë ashtu klasën e katërt n'gjimnaz, t'nesërmit u lajmrumë n'gjimnaz, faktikisht me vanesë. U lajmrumë n'gjimnaz, po mësim jo se jemi t'libër me përgatitë semimaturën. I kishin kapë këta, Rexhep e me Ahmet e edhe shumë tjerë, Karolina Franin, e... s'e di a njeh kush, a s'e njeh. Po, femna, e djemve t'gjimnazit, e kishin mushë një oborr, një oborr t'OZNA-s n'atë far kohe. Ajo OZNA ka qenë afër gjimnazit, e ka pasë një oborr t'mirë, t'madh. I kishin qitë n'oborr krejt, Xhelal Oranën n'rast se dikush e ka njoftë, Nexhat, ata kanë qenë nxanësa edhe studenta t'mirë. Nexhat Orana e kryjti n'Beograd dy fakultete – matematikën edhe teknikën; a Xhelali teknikën e kryjti. Ishte inxhinier, punonte n'Shkup masanej. E këta ishin n'atë kohë nxanësa, edhe ata i kishin burgosë, megjithëse ata s'kanë pasë kurgjo.

Edhe ata n'burg, edhe neve na burgosën dikur n'mramje, po m'thërrasin me bisedu. Shkova, "Ti kundra popullit, e kundra neve, e kundra..." hamomit e... thashë, "Jo bre, kundra unë s'kom gjo", u mendojsha me tregu që une juve ju du, po, e mos o Allah s'e honkshin. Nejse, ma dhanë njifar dajaku, m'majtën disa ditë, unë isha hala i ri për me m'qitë n'gjq m'lëshunë. Ata tjerët i qitën n'gjq edhe i dënunë besa bukur mirë, unë shpëtova pa ra n'burg. Xhelali jo, Nexhati jo, se s'ishin anëtarë.

Po, 74 vetë u burgosën ata aty, prej atyne 74 vetëve na tre vetë a katër vetë që ramë n'burg, katër vetë po, ramë n'burg. Mu m'lëshunë, katër metën, faktikisht pesë paskan qenë, katër metën. Dy i dënunë, dy i

lëshunë, Ahmeti u dënu tre vjet, Rexhepi dy vjet. E prej s'jashtmit ishte Xhahid Gafurri, ndonëse dikush e ka njoftë atë familje, Xhahidi ishte n'grupin tonë, edhe ai n'burg e dënu në pesë vjet, edhe ai i majti ato pesë vjet.

Edhe mu m'përrjashtunë prej shkollës, *doživotno*⁴ mos mu kthy mo. Dy vjet nejta jashtë, pa shkollë, pa... Mas dy vjete deshta m'u punësu n'Prishtinë, me gjetë nifar pune, m'u kish rritë menja që di me punu. Mirëpo, kishim një drejtor n'atë far vakti ni korçar, drejtor shumë i mirë, shqiptar shumë i mirë.

Lura Limani: I shkollës?

Enver Tali: Ai i shkollës, gjimnazit. Qe edhe atij s'po m'kujtohet emri, po ai n'korzo unë isha me një dy shokë, edhe ai ishte t'u shëtitë me do arsimtarë e profesora. U nda prej tyre erdhi, "Ec," tha, "ti këtu". M'nxurrë edhe mu prej atyne dyve. "A ke çu dokumentat për m'u regjistru n'skollë?" Thashë, "Jo s'i kom çu se mu m'kanë thonë s'kom t'drejtë m'u shkollu mo". Tha, "Menjherë me i marrë dokumentat nesër me i pru n'gjimnaz," ai m'regjistroi. M'regjistroi po përsëri n'klasë t'katërt, a shokët e mi kishin shku bukur gjatë, gjeneratë e Fehmi Aganit e qësi far. Larg kishin shku ata, po u pranova edhe ashtu, edhe ashtu u pranova. U pranova, po, dhe me vështirësi. Shpesh m'thirrshin n'marshin, s'guxojsha me kërkoni me bisedu, i mirrsha n'qafë edhe ata që..

Edhe, kur erdhi puna m'u regjistru, u regjistrova n'klasën e pestë masi e kryjta t'katërtën. Edhe u regjistrova n'klasën e pestë. N'klasën e gjashtë mirë kalova. N'klasën e tetë ka qenë njëfar... histori na jepke. Ai kushëri i Zeqeria Rexhës. Nejse, ai edhe si duket, e kishin çu n'Beograd me studiu historinë. Katër vjet i kanë dhonë jo bursë po rrogë edhe e kryjti ato, ky veç indeksin me veti, ka dalë prej atyhit pa dhonë asnjë provim, mirëpo ishte njëri i tyne. Ai edhe e bonën përsëri profesor i historisë, mësimdhanës, ligjiërues. Ai nuk m'durojke, ja nuk m'durojke. Unë i frigojsha atij se po m'bon ndonji sherr. N'klasën e shtatë, ashtu e kryjta dhe e kryjta jo po hala s'kishim marrë rezultatet. Ai m'kishte rrëzu n'klasën e shtatë, po n'provim. Bohet, s'bohet - n'provim. Kalumë, afati për me hy n'provim me dhonë provimin.

E kishin formu ni komision, Idriz Ajeti anëtar i komisionit, ni ruse që jipte histori n'gjimnazin e serbëve, edhe dy tjerë nuk e di kush ishin, m'shtinë n'provim. Ajo rusja e kishte mushë një ballë të klasës me... përplot, jonë do klasa atje n'gjimnazin me shkollë, aty plot profesorët t'skollave të mesme, serbë e shqiptarë se u ba bujë ma me atë punë, kishin ardhë. Ajo me harta e kishte mushë harta historike, 43 minuta, pesë s'i boni po... se e kqyra orën. Për 43 minuta, dul para ktyne që kishin ardhë aty, i kryqoi durte {kryqëzon duart në gjoks}. "Gospodo..." se ata folshin, ishin borgjezë, edhe rusë që i kishin njëkë prej Revolucionit. "Gospodo, *čiste savesti*", tha, "potpisujem pet" ["Zotërinj me ndërgjegje të pastër, ja jap peshë"]. Idriz Ajeti, "Ne, ne pet, četiri" ["Jo, jo pesë, katër"], Idrizi ky i joni. Vetmeveti t'hiqna prej atij helaqi, çka t'dush. Edhe une nuk e di çfarë note, a met' katër a pesë. Qëto muhabete u bonën, edhe une kalova n'klasën e tetë.

⁴ Srb. *Doživotno*-përjetësisht.

Klasën e tetë një sherr tjetër m'zuni. Ismet Deiri n'koftë që e ka njoftë dikush, matematikë na jepte neve Ismeti, po ishte i rreptë. Ishte i rreptë, po matematikën unë e kam punu, për matematikë s'kisha kurrnifar telashi. Ismeti n'klasën e tetë m'rrëzoi n'matematikë, n'provim. Mirë. Erdha n'vjeshtë me dhanë provim. Ahmet kushi u qunte ai i kimisë, ai m'jipte kimi, ato e kisha pasë deri n'klasën e katërt n'gjimnaz shok klase, ai po m'jep kimi. Kur erdhi me m'dhonë kimi, zaten m'ndikunë edhe... p'i thomë, "Ahmet mos grij mut!" m'falni n'shpërhje, "Me lujtë sikur k'ta ti me mu, se t'vraj pushkë e krejt". "Hehe," keshi (qeshë).

Mirëpo, erdhëm me dhonë provimin e matematikës. E dhashë provimin e matematikës, bile, bile kryetar komisioni për matematikë ishte një rus që jpte mësim gjimnazit serb. Si sot i maj n'mend detyrat, se për shkak t'atij rusit serbisht, "Izvodjenje pitagorine teoreme" ["Zbatimi i teoremës së Pitagorës"], s'ishte gjo ajo punë. Masanej, ishte ajo një detyrë prej analitikës, edhe aty s'kish pasë... edhe një detyrë ishte analitikë, trigonometri, detyrë e gjatë, edhe atij i dola n'fund. Pa dalë te Belo Sokolci edhe Ismet Deiri, po n'vend i bona aty, edhe ato... se na jipshin një ashtu me punu n'vend. Atë punim ashtu ia çova rusit, "No, no, no!", erdh Ismeti pe kqyrë, s'ka kurrënfat gabimi. Tha, "Pitajte kandidatet çijem metodom", ["Pyeteni kandidatit se me cilën metodë..."] si sot m'kujtohet, "izveo Pitagoreono Teoremo" ["e ka zbatuar teoremën e Pitagorës"]s, ai po ma përsëritë rusi. "Ja sam imao pitanje 'Izvodjenje Pitagorine Teoreme'. Ja sam izveo." ["Unë e kam pasë pyetjen 'Zbatimi i teoremës së Pitagorës. Unë e kam zbatu."] As s'boni zo kërkushi, u çu Shyqyr Qehaja, ka qenë na jepte histori, ishte i Prishtinës. Kështu erdh te Ismet Deiri, p'i thotë n'vesh kishe ai u nijke tha, "Ta lagu bre Ismet, po rri trus bishtin" (qeshë).

Po, shkoi ai, ia kthei shpinën, nejse mu ma njoftën klasën e tetë edhe maturën e morra. Maturën e morra me matematikë. Ajo... ai presion i Ismet Deirit, kishte ardhë prej Ahmet Malokut. Ahmet Maloku s'un m'ka rrëzu mue. E kta, punojshin n'ato kurset pedagogjike n'atë kohë, msusat. Këta dy mësimdhanësa n'ato kurse pedagogjike, flejshin n'internatin e Normales, edhe ay jonë marrë vesh. Ky i ka thonë, "Me ma rrëzu ti mu Enverin", ky edhe m'rrëzoi nime. M'rrëzoi nime po i ka hongër një dy-tri grushta se ai u tutke masanej prej meje, edhe u frigonte, shkante truq, a une e pritsha, e kom pritë vazhdimisht.

Ka ardhë prej korzos u nda, ku osht tash muzeu, aty kur hin te muzeu, një rrugicë teposhtë aty, u ndajten ato shokët që e përcillën, që ishin bashkë, ky met' vet. Edhe, s'kish kah... ai m'pa mue, s'kish kah me ia mbajtë, edhe u nisë me shkue, ishte fejue me një vajzë aty n'atë rruqicë e me shku te miqt aty te e fejumja. A lele teposhtë, ta nxo une t'i mshoj dy grushta t'mira. Dera mshelë e m'iku, mirëpo ky bam bam bam me shkelma, u çunë ai miku me ia çelë derën, e une ia ktheva shpinën edhe pshtova pa telashe.

Lura Limani: Kjo o' mbas provimit apo?

Enver Tali: Mas provimit, mas provimit. Edhe, kështu që nuk pata kurrnifar problemi, veç e di që ata që m'kishin pa aty pari, se jo, kërkush tjetër. E këtu, kështu e kryjta gjimnazin unë, me këto peripeti të kijametit e deri këtu erdha.

Pjesa e Tretë

Lura Limani: Pra, tash vazhdoni për jetën profesionale.

Enver Tali: E kryjta gjimnazin, edhe tash, gjithmonë mendojsha n’studime. Kam pas qef me ndjekë matematikën, me kry matematikën edhe u regjistrova n’Beograd n’Fakultetin e Matematikës. Mirëpo bursë jo, pare jo, mos me thonë vorfni po, skamje po. Njo ni mujë ditë mu m’majtën Xhelal Orana edhe Nexhat Orana si, n’internatin e tyne, n’domin [konviktin] e tyne si ilegal, mirëpo nuk shkojke ajo ilegal tanë kohën. Njo ni mujë ditë nejta, mas ni mujë dite, dola. Dola me ardhë mas ni mujë dite, erdha n’Prishtinë. N’Prishtinë s’kishte Fakultet n’atë kohë, edhe tentova m’u regjistru, me gjetë ni punë edhe m’u regjistru n’Fakultetin e Shkupit, qishtu ndonji jurisprudencë a diçka. Thashë diçka me kry, po jo matematikë s’t’vyn matematika privat, s’ma merrke mendja.

U punësova. U punësova n’Entin për Sigurimin Social. N’atë kohë njerëz me kalem s’kishte, kush kishte nji kalem u punësonte shumë lehtë, po unë u punësojsha shumë vështirë. Faktikisht Entin për Sigurimin Social pak ma vonë u pasna punësu. Po, u punësova me nji sipërmarrje turistike, hotel e turizëm e kishin krejt Gilani... si arkivist me ia majtë evidencën ashtu. Aty punova njo dy vjet, m’qitën, m’qitën prej atyhit. Edhe kërkujsha me u inkuadru n’mësim edhe unë, edhe aty s’pranojshin, s’ishte për mu, “I papërshtatshëm,” thojshin. Fillova me kërkë punë, diku me punu, çkado që do t’thojsha, punë me marrë ni rrogë për ekzistencë. U punësova në këtë... qi thashë pak ma parë.

Lura Limani: Entin?

Enver Tali: Po.

Lura Limani: Enti për Siguri?

Enver Tali: Për Sigurimin Social. Aty ishin do njerëz shumë t’mirë, m’nihmojshin, bile, bile mundem thonë se asgja s’kom punu tre vjet, se s’ëm lojshin ata. Krejt punët m’i mirrshin ata, punojshin, unë veç ecsha, atyne iu dhojsha, “Ju do të m’leni pa bukë, bre. Duhet me mësu diçka me punu”. “Mëso matematikën ma bojshin”. Nejse, edhe aty mirë, mirë kalova, po edhe prej atyhit m’qitën. M’qitën, kur m’qitën prej atyhit, gjithmonë n’mendje m’u regjistru n’matematikë. N’matematikë s’un u regjistrova, s’un regjistrova se s’kisha mundësi, s’kisha ashtu... mundësi materiale s’kisha.

U njoftova me këtë grunë që e kom, kjo e kish kry pikturën n’Shkollën e Naltë n’Shkup, piktore. Mirëpo, edhe ajo s’ish me pozitë t’mirë politike po mendoj. Edhe masi u martova me to, ajo mirrte nji rrogë, u punësue. Mirëpo nji rrogë edhe ashtu, mirë, mirë u bo.

Lura Limani: Si e ka emrin gruja juj?

Enver Tali: Nesrine. Edhe m’u punësu edhe motra, ajo ishte 14 vjeçare. Po m’u punësu s’ma pranojshin, s’ma pranojshin m’u punësu. Edhe njoni ma boni, “Hajde se po ia rritim vjetët, po ia bojmë 16 me

punësu”, edhe ia rritën vjetët, ia bonë 16, e morrën n’punë edhe ato. A do t’fillojë tash me marrë tre mijë dinarë se ishte ajo shtesa fëminore, a ça ishte ajo që i merrshin për fëmi. Edhe, çdokush që u punësonte, n’rast se ka dikendin që e man, edhe ai mirrte tre mijë dinarë. Edhe unë mirrsha tre mijë dinarë. E me ato tre mijë dinarë shkova u regjistrova n’shkollë, n’Fakultet. N’Fakultet vazhdova mirë, mirëpo m’kapën n’burg.

Lura Limani: Pse ju burgosën?

Enver Tali: Hë?

Lura Limani: Pse?

Enver Tali: Pse i papërshtatshëm (buzëqeshë).

Lura Limani: A t’ka ndodhë diçka specifike n’qat kohë?

Enver Tali: Si thatë?

Lura Limani: A keni bo... keni ndërmarrë ndonji aksion specifik n’atë kohë para se m’u burgosë?

Enver Tali: Po, u murrë vesh. Baba i këtij djalit si e qujnë, Liburnit, Kadri Halimi n’rast se keni ni për ato një etnolog i fortë, ipte mësim n’Beograd ai si etnolog. Ai, une edhe formumë... edhe disa tjerë formumë një organizatë e shqiptarëve për bashkimin kombëtar me Shqipninë, për bashkimin kombëtar me Shqipninë, edhe për shirimin prej Serbisë. Vazhdoi ajo punë.

Lura Limani: A keni vepru n’Shkup, apo n’Prishtinë?

Enver Tali: N’Prishtinë, n’Prishtinë, Prishtinë. Vazhdoi një kohë kështu, prej Shkupit u ndava se s’kishim mundësi. U ndava prej Shkupit edhe i kisha dhonë do provime për jurisiprudencë, bile ajo Drejtësia Romake ka qenë landa ma e vështirë në Shkup. Ato e kisha dhonë une edhe Bardhyl Çausi, edhe Bardhyli, me t’parën se kërkush me t’parën s’un e jipte atë Drejtësinë Romake, tash m’u kujtu.

Edhe nejse veprumë, kush sa mujt me vepru. Mirëpo, shkova n’Beograd une me gjithë grunë, se m’thirrën me punu n’Gjilan për ngritjen e veprimtarisë kulturore, artistike atje. M’çunë n’Beograd nja ni mujë ditë në ushtrime, atje me pa se si punohet. Kur u ktheva prej Beogradit, axha ishte gjallë n’atë kohë, kish dalë me m’pritë n’autobus tha, “Ik prej ktuhit se shokët t’i kanë burgosë krejt”. “Çka kom lidhje une me shokët që m’i kanë burgosë?”, “Po t’thomë n’rast se ki lidhje, ik prej ktuhit”. S’livrita, s’livrita, ata kishin ra dikun n’marim t’frorit, n’fillim t’marsit, unë rash n’prill n’burg, qatëhere m’kapën, edhe na denunë me burg. Majta edhe atë burg edhe m’lishunë prej burgut, po pa shpresa që muj t’boj diçka n’jetë.

Ato që i ksha mendu me regjistru, matematikën masi veç u bonë këto rrogat e grusë e t'çikës e t'motrës, shkova e regjistrova si i rregullt matematikën. Matematika n'atë kohë n'Fakultet ishte ashtu dy pjesë, dy, si i thojshin asaj...?

Kaltrina Krasniqi: Semestra?

Enver Tali: Jo semestra, po shkalla e parë edhe shkalla e dytë. Unë shkallën e parë e kryjta, e kryjta edhe fillova me kërkun punë. Kërkush s'ëm pranojke, edhe pse n'atë kohë matematika ka qenë landë deficitare. Matematikën me shkallë t'parë me pasë dikushi, ishte mesele, mirëpo, jo n'punë. I ri u demoralizova pak, se unë kurrë s'jom demoralizu, as s'jom frigu bre, po kjo do t'kryjë edhe shkallën e dytë mos me m'pranu n'punë në këtë mënyrë, çka bohet me to.

Edhe u tërhoqa unë prej... i kom pasë dhonë do provime t'skallës t'dytë, viti i tretë, mirëpo u tërhoqëm. U preka me thonë, njëfar demoralizimi që unë shpesh nuk jom demoralizu n'jetë, po këtu gabova. Edhe, u tërhoqa, u tërhoqa në shtëpi, erdha në shtëpi. Burgun e kisha majtë, s'e di a ju thashë. Edhe, dikush tinëz m' respektojke, dikush natyrisht donte me fitu poena prej meje, e kaloi, kalova diqysh ku u transferova me familje n'Prishtinë. Se une n'Prishtinë, se une n'Prishtinë kom jetu prej '45-shit, po kur jom tërheqë ma vonë prej atyhit edhe erdha n'Gilan. Edhe do t'tërheqna prej Gjilanit, erdha n'Prishtinë. N'Prishtinë, me punu gjo jo. E shita atë shpinë n'Gjilan. Po ato ishin pak pare. Jo unë nuk isha n'punë, me kredina. Po kisha shokun unë atje.

Pra, erdha n'Prishtinë, edhe n'Prishtinë s'un gjejsa punë. E msova një zanat kur ma morrën shpinë, me pre hekra, me drejtu hekra, me laku hekra për ndërtim po mendoj. Ato shkojshin me kile, ata që punojshin ma heret, që kishin fillu me punu, merrshin tre qind dinarë n'kilogram. Une e zbrita n'280, mandej edhe kisha mjaft t'njoftun unë. Kam qenë pak a shumë, i dashtun prej tjerëve. Edhe, punë kisha mjaft, po hekrat nuk ishin si tash këtu, të drejta, prej e lakoj e. Po ishin ato baullat deri 120 kilogramë, e ato u deshte m'i shtri, masanej m'i lidhë dikun e m'i ngrehë, m'i drejtu e masanej m'i pre simas projektit. Prindët m'bijshin projekte, e n'bazë t'qatyne projekteve i prejsha, lakojsa, i drejtojsa, ata vijshin i marrshin. Po, kurrë njihere nuk kom pasë ndonifar lloj telasheje dikushi me m'thanë se m'ka metë shkurtë, e m'ka metë gjatë e...

Por njeni ma pruni projektin, simbas projektit s'kishte punu shpinë, po njo ni metër ishte zgjanu në njanën anë, kështu që hekrat për ni metër ma t'shkurta. Kur ia çova, "Sa m'ke marrë n'qafë bre". "Çka u bo?" "Se shkurtë m'i ke lonë". Edhe une e marr projektin që ma ka pru ai, e mati, thashë, "Dil mate edhe ti". E mati edhe ai edhe erdh n'veti. Tha, "Jo s'ke faj ti, po unë objektin e kom lëshu ni metër n'këtë anë", "E tjetër muhabet. Mirëpo", thashë, "Këto nuk t'hupin tye, se do t'ketë një arsye me këtë gjatësi t'hekrave t'punohet në një vend", thashë e "E i ndërroi i marr t'tijna e prej për tye". Edhe ashtu ndodhi aty që edhe atij, edhe ato s'i damtova se i vnova, edhe vet, pshtova pak ma lehtë.

Kështu kam punu hekra, mirëpo, m'u kanë pagu ato hekra, m'u kanë pagu, shumë mirë m'u kanë pagu hekrat. Edhe, se isha shumë keq une, me një rrogë t'grusë, motra m'u martue, me një rrogë t'grues meta.

Pagujsha qira t'shpisë, keq ishte situata, por këto që fillova me punue, arrita, arrita shumë. Edhe, e ndërtova shpinë me kredina, edhe kredinat m'ndihmojshin, m'kanë ndihmu shumë shokët. Kur dilte ni kredi, se unë s'kisha t'drejtë me marrë kredi, se s'isha n'marrëdhanie t'punës, por ata ma sigurojshin me nrxanë mu borxhli s'i metsha atyne, se punojsha me hekra.

Kështu që e ndërtova shpinë, e ndërtova shpinë edhe jetova mirë, mirë jetova. M'merrshin nganjëherë n'burg, jo burg po m'majshin tri-katër ditë, m'lëshojshin. Si i papërshtatshëm, natyrisht unë nuk kisha naj... me vnu n'lojë jetën e fëmive e t'familjes. E m'lishojshin, me fjalë tjera, mirë.

Lura Limani: Për cilat vite jeni t'u folë të 50-tat, apo 60-tat? Për cilat vite po folni?

Enver Tali: Çfarë vite?

Lura Limani: Po çfarë vite përafërsisht?

Enver Tali: Ah, vitet... këtë shpi e kam fillu n'vitin '79, '79. Këtë trollë ma ka lanë, ma ka pas dhonë Omer Qerkezi, ai ishte drejtor i ktyne trojeve. Dhe, Omerin e kisha pasë dikur shok klase, katër klasë gjimnaz t'krymë me to, e m'nihoi. Kredinë e parë që e morra, i thashë, "Ta paguj borxhin", kur e morra kredinë e parë tha, "Mos e paguj borxhin, po fillo me punu me vu teme le dikun se masanej bohet ndonji kredi tjetër e...". Edhe ashtu u bo ajo.

Po, po thomë, m'kanë ndihmu shokët, jo m'kanë ndihmu që m'i metë... pa i pagu gjanat, po i kom pagu atëherë kur kom pasë mundësi me i pagu. Kur u kry shpija, mandej une i hina punëve, diku-diku edhe me zgjanu, diku me përmisu, atë pjesën anena krejt vet e kom punu {tregon me dorë anën tjetër të shtëpisë}. Vet e kom punue, hiç pa ashtu, pa ndihmën e kërkujt, edhe mrrina. Mrrina shumëçka, mrrina me punë.

Erdha hyna n'shpi, kërkitën këto muhabetet e këtyne punëve tona. Filloi, fillunë burgosjet, fillunë kijametet. Nji natë kah mëngjesi, hala pa u zditë, ish rrethu krejt kjo mahallë, kjo mahallë n'rrethinën e policëve që kanë ardhë prej Serbisë. Atëherë i kanë dhonë adresë, mirëpo hala n'atë kohë u mbulojke... jonë shpijat t'pakryme, jo shpijat n'fillim e... ishte e vështirë m'u gjetë. Këta kanë ardhë me m'lypë mu me emrin, me germën e parë E, kishin hi te nji kojshi aty përfuni kodrës n'lug aty ku u lakumë. "Enver Talin na gjoni". "Une s'jom Enver Tali, qe librezën" e pallavra, "Ku e ka?" A t'ka tregu, a s'të ka tregu une nuk e di. Qata ia kanë msy qitij objektit. Tash kur kanë ardhë n'këtë objekt, kjo hymja jeme osht poshtë sikur që e patë, e Emrushit osht' naltë. Tash ma lirë ishte me shku te Emrushit se me ra poshtë me kërkun dikonin.

Unë i kisha ni, i kisha ni une, se deri vonë punova diçka, e masanej kur rashë m'mirrke edhe s'ëm mirrke gjumi. Kur erdhën këta, erdhën me kamiona, erdhën me xhipa me... u rrethu këtu. U çova me kqyrë, e rrethume, edhe thashë, "Marova me këto". Po s'i trazova, poshtë punojsha, s'i trazova grunë e fëminë jo, ata flejshin naltë. Këta kanë shku te Emrushit, kanë hy te Emrushit p'e lypin Enver Talin se i thotë, "Une nuk jom Enver Tali", "Kush je ti?" "Emrushit", thotë, "jom une" ... S'e di si e patë mbiemrin. Edhe thotë, "Qe", edhe ai komandanti bohet nervoz, ai që udhëheqë me këto, "Mlidhnu!" policisë. Policia... unë kisha hy

osht' ni toalet poshtë aty te... kisha hypë qaty për ni dritare t'vogël, e përcjellsha një pjesë t'lëvizjes t'ktyne policëve. E pashë po mlidhen po shkojnë, po u zditë mo. Po dojnë me shku e krisën kamionat, xhipat u ngarkunë, ata shkunë. S'ka mo kurgjo kërkun.

Unë tash, e ka pa mahalla tash diçka dijnë. Këtu ksi far' lloj çeshme m'i la sytë e kroi e m'u la edhe vet e sa t'dush. E mora ni peshqir e dola, asht' një kojshi këtu e kishte një krue n'oborr. Shkova po i laj sytë hala pa u çu ata, p'i laj sytë n'oborr t'tijna. Një Zenel Kastrati osht', n'burg osht', ai e kish pa krejt gazepin, e kish përcollë prej asaj ane matanë, matanë lugut osht', edhe ai n'shpat ashtu {dëfton kah ana tjetër e shtëpisë}, e ka pa këtu se çka po marohet.

Kur dola unë përjashta qashtu, ai s'ka flejtë mo. "O Enver, o Enver", p'e këqiri Zeneli. "Çka Zenel?" Tha, "Eja, eja", thashë, "Qe, qe", "S'po du me [t']pa se e mora vesh që kanë hy te Emrushit. Thashë, "Prit pak", shkoj i lajta sytë e me peshqir n'krah, erdha te Emrushit, hina aty erdh gruaja edhe burri, n'kuzhinë me ni tavolinë ishin pshtetë ishin bo. "Mirëmëngjes", "Mirëmëngjes", ata "Mirëmëngjes!" u çunë, tët tët tët, thashë, "More, a keni pasë mysafirë sot?" "Sonte a? Jo bre çfarë mysafiri", gruaja tha, "na kanë ardhë policia". "Çka lypshin policia?" thashë, "n'atë kohë". "Jo" tha, "e lypshin..." "Kon e lypshin?" Emrushit ia nisi me kallxu emra tjerë, jo Enver. Kjo gruaja tha, "Jo Emrush, jo, Enverin e lypshin, Enverin", "Eii," thashë, "sa Envera ka n'këtë lagje, hiçu atij muhabeti".

Dola prej ktyne, shkova te Zeneli. "Çka u bo? A pshtove?" Thashë, "Pshtova", tha, "Po tash çka do t'bajsh?", "Tash mushe kerrin benzinë, bonu gati, bohna gati edhe une, tash m'hypë n'kerr, m'çon për Shkup". "Po edhe?" "T'na zofshin ti je taksist, unë si taksist t'kom marrë ty". "More" tha, "edhe me ardhë me ty s'e kom gajle", osht' shumë burrë i mirë po e zuni një taksirat. Edhe, erdha n'shpi, s'pi nguci këta po flejnë hala. Derisa u bona gati, u çu gati "Çka?" thashë, "Unë shkova n'Shkup nihere, pa le ku përfundoj". "Ani", se edhe ajo e pa që...

Edhe, aty te Zeneli hypa n'makinë për n'Shkup. Ai nëpër katunde nëpër do rrugica, ishte i aftë për këto punë, m'qiti matanë kufinit t'Serbisë n'Maqedoni. Kur mrrina n'Maqedoni shkova te këta t'axhës, u gzunë ata thashë, "Për çka po gzoheni? Une i ikun jom". Thashë, "Mos po ju nxen ndonji sherr, mos po ju nxen", se edhe ata kanë vujtë nëpër burgje. Ai axha i vjetri që ka vdekë ishte moshatar me babën tem, ai kishte ra n'burg tetë vjet herën e parë, tre vjet herën e dytë. E baba i qasaj Erëmirës që tregova, jo, gjyshi i Erëmirës edhe baba i Erëmirës ka pas ra pesë vjet si jurist, jurist i diplomumë. Domethanë kjo familje e jeme ka vujtë me këto burgje, me këto pallavat e serbëve.

"Mirë se ke ardhë, shumë bukur", nejta një ni mujë ditë. Ma boni ni pashaportë fallco me shku n'Turqi. Me atë pashaportë fallco, mrrina n'Turqi. Kur mrrina n'Turqi, u lajmrova n'qeveri.

Lura Limani: N'cilin vit ka ndodhë kjo?

Enver Tali: Si?

Lura Limani: N’cilin vit ka ndodhë?

Enver Tali: N’vitin... në ’79⁵, po. N’vitin ’79... n’fillim t’vitet ’79 m’duket, n’marim t’78, aty pari. Po hala luftë s’kishte kërshitetë këtu, s’kishte asi far rreziqe. Nejta aty njo ni mujë ditë, ma rregullunë një pashaportë fallco, me atë pashaportë fallco shkova n’Turqi. N’Turqi i kisha unë dy motra me familje me ashtu. U prita mirë prej motrave, kisha nipa atje, kisha. Te ni nip shkova nejta njo dhetë mujë, mirë kalova, shumë mirë kalova. Mirëpo, s’bojsha kurgjo, isha i vdekun. Edhe, mendova çka mundem me bo këtu, Lobin e Shqiptarëve këtu n’Maqedoni⁶ me formu. Ishin do shoqata këtu që ishin formu, shoqata kosovare, po mendoj shqiptare, edhe me ta u lidha, vuna kontakt.

Diku kur vuna kontakt me një shoqatë turke, pastër turkë. Me ato turqë kishin formu një shoqatë për solidaritetin me Bosnjën, se atëhere u bonte luftë n’Bosnje. Edhe thashë du me shku me vu kontakt me ta, derisa janë kaq t’kujdesshëm për njerëz tjerë, edhe une jam i huji. Shkoj aty, m’presin mirë, unë turqishten pak a shumë e dijsja. Edhe, thashë, “Unë nuk kom ardhë me...” se ata m’porositën me pi e me... diçka me... thashë, “Unë nuk kom ardhë me hangër e me pi, po kom ardhë me punë”. Ah mund ta marrin me mend ate, e përsosën situatën.

Po ajo shoqatë ishte e formume prej doktorëve t’shkencës ashtu... para-doktoratë, çka ishte ajo, masterllëkit, krejt mastera ishin edhe doktora t’shkencës. Kryetari ishte me dy fakultete, kishte Fakultetin e Medicinës me Fakultetin e Historisë. Sekretari e kishte Fakultetin e Ekonomisë e magistraturën e kryme. M’pranunë mirë, shumë mirë m’pranunë, jashtëzakonisht mirë, edhe po m’japin tash me shkru me marrë pjesë une n’ato mledhjet, se une e paraqita situatën. Po, i thashë, “Unë jom paraqitë n’qeverinë turke, kom tregu se s’kom pashaportë, i kom tregu se i kam, mirë”, thashë, “kto e dinë qeveria turke”. “Hiç mos ki marak se e rregullojmë”. Ata ishin krejt intelektualë që i përgatitshin referatet e fjalimet e ktyne udhëheqësive turqë.

Me këta kalova mirë. Kur shkova s’dyti në takim, ai kryetari po m’thotë se Enver Bej m’thirrshin a, “Enver Bej,” m’tha, “A pranon për...” jo, “Ti je mas sodit msusi jem, *hocam* i thojnë turqisht, “Msusi jem,” shujta une. Se ky sekretari tha, “Enver Bej,” tha... se ndërkohë ishin marrë vesh, se i kom dy djem përjashta, ky i vogli ishte n’Angli n’atë kohë, Kujtimi ishte në Amerikë. “Ni djalë,” tha, “e ke n’Amerikë, ni djalë e ke në Angli, a pranon ni djalë me pasë n’Stamboll?” Hiç s’bona zo, as atijna s’i dhashë përgjigje, mirëpo, me t’vërtetë m’u kanë gjetë si me pas’ pasë t’familjes t’ngushtë. Krejt çka vijke aty që m’kërkojshin, ma s’pari iu drejtojsha ktyne, ma s’pari “Çka osht’ kjo?” Ata jo vetëm që ma shpjegojshin, edhe ndërmerrshin diçka për atë muhabet që u bo. Unë u afirmova shumë mirë.

E formova Lobin ... ni shqiptar këtu, shok klase e kom pasë pisin, ka deke, mos t’hi n’gjynah me to. Edhe në ni takim, në ni mledhje që kishim, po Lobin e formova une, isha doktora t’shkencave, kisha mik advokatin, kisha afarista, turista... po mendoj ksi biznismena, kisha shumë, krejt shqiptarë, krejt shqiptarë

⁵ I intervistuari gabon, ka mbërrë në Turqi në vitin 1991.

⁶ I intervistuari gabon, është duke folur për Turqi.

kanë kenë po të turqizumë. Në mledhjen e katërt, e qai shqiptari i Prishtinës shok klase që e kisha, tha, “Enver,” se ai Enver Bej nuk m’thonte se ishim shokë të fëminisë, “Enver” tha, “duhet me t’shprehë une ty”. “Çka don me shprehë?” “N’rast se paraqitet ndonji i krishterë me marrë pjesë n’këtë shoqatën tonë, unë e lo shoqatën”. Thashë, “Ti a e din që unë jom anëtar?” Tha, “Po”, “A e din se shqiptarë ka edhe t’feshë krishtere katolike edhe ortodokse? Ata jonë vllazën t’mi prej gjakut. A morre vesh ti?” atijna. Ai u bo vet i 40-ti, mirëpo m’i mlodhi betë.

Edhe, mledhjen e katërt pa mu e kanë majtë... t’pestën, pa mu e kanë majtë. Ky [e pakuptim.] ashtu, edhe ftofen ashtu, edhe mledhjen e pestë prishet ajo shoqata e shqiptarëve që i kisha formu une. Mirë u prish që u prish, tash i kisha turqit këta të cilët i njoftsha. “Unë”, thashë, “jom pa pashaportë këtu, a e dini ju?” “Po, po na ke thanë”. “Mirëpo ju s’keni ndërmarrë kurgjo pse kom thonë une, tash m’duhet përsëri me përsëritë”. “Çka mujmë me bo na?” “Ju mundeni me bo, me m’leju me çelë ni përfaqësi t’Kosovës këtu”. “Bohet” ... “S’bohet” ... “Po une nuk po thomë me çelë ambasadën, me çelë konsullatë – përfaqësi t’Kosovës”. “Eh do ta shofim”. Mas katër dite erdhën m’thanë, “Përfaqësia jote mund t’formohet”, une e çela përfaqësinë.

Mirëpo, kisha hall me këta shqiptarët tonë t’Kosovës. Ato përfaqësi, ato gjana m’i pagujke krejt Kujtimi, këta s’livritshin me... veç kqyrishin çka me marrë e me dhonë kurgjo hiç. Po s’bojsha zo aty hiç. Kur e çela zyren e përfaqësisë t’Kosovës, m’thanë, “Simbole prej jashta objektivit mos me qitë, po mrena objektivit çka t’dush qit”. Thashë, “Unë simbole nuk qes, po firma që osht’ objekti i përfaqësisë t’Kosovës” thashë, “ato duhet me qitë edhe n’shqip edhe n’anglisht”. “Pse?” Thashë, “Po kur vijnë shqiptarët prej Kosovës, qysh m’lypin mu? Ku jom une?” Edhe ato ma lejunë. Une edhe n’metal m’i shkrujtë krejt shqiptarët e ktuhit - përfaqësia e Kosovës në Stamboll, Republikës së Kosovës në Stamboll, edhe anglisht e shkrujtën në dy gjuhë. E qita te dera e pallatit, edhe atje naltë te dera e hymjes, n’atë far’ objekti çka i thojshin, objekt...

Pjesa e Katërt

Përfaqësia kishte sukses. Çdo... shumë shtete e njoftën përfaqësinë. E njoftën jo zyrtarisht me u shfaqë, por vijshin edhe m’thirrshin n’takime e biseda amerikanët, anglezët e gjermanët me përjashtim t’rusëve që s’i kom dhonë ftyrë, serbëve s’i kom dhonë ftyrë, bullgarëve s’i kom dhonë ftyrë, edhe bullgarëve jo, edhe dikujt tjetër n’këto far’ muhabete, se tjerët e kanë pasë derën çelë. Jeta ime ma e kandshme edhe pse ma e vështirë, po ma e kandshme ka qenë n’Turqi, nuk kom mujtë me bo jetëm ma t’kandshme. Jo pse kisha me hangër ose s’kisha me hangër, kisha me pi ose s’kisha me pi, ishte marifeti punën që e bojsha, punën që e bojsha dilke n’sipërfaqe. Ajo ishte ushqimi jem ma i miri.

Po e zomë, lufta që kërsiti në Kosovë, kishte t’ikun prej Kosove, m’i vendosë ato nëpër kampe. T’vendosun nëpër kampet ma t’mira që kishte n’atë kohë Turqia. Për 20 mijë vetë ishte një kamp i formumë n’hymje të kufinit atje... qe harrova, p’i harroj emnat tash, edhe numrat. Edhe aty, ai kamp u mushë me 20 mijë. Ai kamp ishte i hapun për boshnjakët se lufta n’Bosnje ishte bo përpara, mirëpo ka marrë fund lufta e

Bosnjës, ajo ishte shprazë. Mirëpo, ai far lloj kampi për shtatë mijë vetë ishte. Për 20 mijë vetë tash duhet me çelë, 20 mijë vetë, për 20 mijë vetë Turqia e rriti atë kamp. E rriti atë kamp me ushqim, me fjetje, me çdo gja të mirë që ishte, gjana t'mira që mund t'përjetojnë ata njerëz.

Kërkova spital, jonë do spitale n'rrota, t'mdhaja me... spitale ashtu me mjekë t'vetë e me gjitha llojet e spitaleve i prunën n'kampe ashtu... në këtë kampin e refugjatëve. Mirëpo, s'kishin pru kampe për femna, edhe kishe shumë femna aty, ishin shtatëzane u dukshin, edhe p'i thom atij, ishte një mjek shefi i tyne, thashë, "Po a e shifni se unë kam këtu femna që kanë me lindë, masanej kam femna që nuk munden me shku në t'gjitha spitalet se s'kemi mjete", pallavra. "Po, po, po", e prunën spitalin n'rrota edhe për lindje, e prunën çdo gja që ishte e mundun, e prunën, edhe unë isha shumë i kënaqun.

Tash, në spital s'po kryhet puna, fillunë me ardhë t'plagosun, krisi lufta, fillunë me ardhë t'plagosun. Mu, unë, bona ni njoftim me shefin e spitaleve t'Stambollit edhe p'i thom, "Çka bojme tash me t'plagosunit?" "Enver Bej" tha, "vetëm diagnozën ma çon ti mu n'telefon, t'ia caktoj spitalin ku duhet me lëshu atë..." U mushë me t'smutë me diagnozë, vetëm diagnozën me paraqitë, t'plagosun kishte, t'smutë kishte. Masanej jo veç t'luftës, po çdo shqiptar prej kahit vinte, prej Shpinisë a Maqedonisë e Luginës t'Preshevës u shërojke pa pikë t'pares, jo t'plagosun, po edhe t'smutë, edhe t'smutë që vijshin. U mushë spitali, një spital u mushë e ashtu me t'sëmutit shqiptarë, bile e qujshin masanej *Arnaut Hastanesi*, spitali i shqiptarëve.

Edhe pse, për asgjë s'kam vujtë, po asnjherë nuk i kom sjellë n'situatë me mendu për mu a po e flet t'vërtetën a po gënjen, jo ato jo, ato jo, haptaz çdo gja që e kisha, haptaz e thojsha, për t'mirë edhe për t'keq. Po, kisha përkrahje t'madhe. Mirëpo, këta shqiptarët tonë vijshin, po e zamë, një here m'erdhën 12 t'plagosun. Edhe m'lajmrunë që erdhën 12 t'plagosun, "Çoni n'filan spitali", se këto punë vet s'un i bojsha une, po kisha ndihmë prej shqiptarëve nëpër shoqata e... t'lrirë e që ishin t'interesumë për çashtjen e Kosovës. Edhe po thom unë, "Këto t'plagosun çoni n'filan spitali edhe aty masanej e din ai se ku duhet m'i çu e çka duhet me bo". Masdite kisha kohë me shku m'i vizitu tash t'sëmutitë. Une pare s'kisha se Kosova s'ëm ndihmojke, s'ëm ndihmojke Kosova.

Lura Limani: A jeni konë n'lidhje me këta t'LDK-së, me qeverinë e Bukoshit, a keni pasë lidhje?

Enver Tali: Me kon?

Lura Limani: Me qeverinë e Bukoshit a keni pasë lidhje?

Enver Tali: Kom pasë lidhje me qeverinë e Bukoshit. Bukoshin 13 vjet e kom majtë n'këtë shpi. Kur ju kom drejtu nihere për ndihmë, "Ja, ja, ja", ia nisi m'u përgjergë edhe e lash', e qita anash. Edhe, nejtse, kish kujtu Bujar Bukoshi me ndihmu, edhe pa lejen teme pa pytjen teme vijinë, një tre vjet kanë ardhë tre mijë marka n'mujë. Be po ju boj qitu se telefonat, katër telefona kisha n'zyre, telefonat për ni mujë ma tepër, ma tepër se tre... n'kohën e luftës, ma tepër se tre mijë dinarë, tre mijë çka marka kanë kushtu n'mujë.

Po, m'ka ndihmu ky djali i madh. Bile, bile në ni situatë n'Amerikë edhe ai n'pozitë t'vështirë e ka shitë kerrin, makinën e vet me m'ka çu t'hollat për Kosovën. Masanej apet hini ai në bursën ishte i njoftun edhe ai për punën që e bonte. Ai m'ka ndihmu, ai m'ka ndihmu, ai m'ka majtë, s'ka fjalë aty.

Ato tetë, që fillova me tregu, ishin vendosë n'spital, shkova m'i vizitu. Edhe do pare që i kisha i pashë kishin ra do tranzistora, ishin liru shumë. E njo dhetë a 12 tranzistora i morra me pak pare. Thashë t'ia çoj ka njo, t'paktën ata turqisht nuk dijnë, shqip noshta munden me zonë ndonji stacion e le t'zbaviten. I çova ato telefona[tranzistora], ai që... dy vetë që m'përcillshin i dhashë me i shpenzue, me i shpërnda ato telefonat. U çunë njo dy vetë m'erdhën afër, në të vërtetë s'em erdhën afër n'shtrat, m'thirrën nërmjet dy shtretëve dy katëshe, "O ti dost," njoni, as shok, as Enver, as zotni as, "Neve na kanë thonë me juve mos me pasë punë". S'e veta kush iu ka thonë, çka iu ka thonë, thashë, "Ti dosti jem, sqarohu nihere këtu për çka ki ardhë, masanej shko tregoj atijna si kalove këtu", kurrë mo s'e kom pa, kurrë mo s'e kom pa.

Ma kanë pru t'plagosunit i kish ra nji copë gjyle hekër, gjyle e topit n'boshtin e kurrizit. N'boshtin e kurrizit, aq keq e ka lëndu sa që e ka qitë përmys, ai kurrë n'komë t'veta as n'krah bile jo, po përmys ka nejtë. E kishin çu n'spitalin e Titogradit, kurgjo s'kishin bo. E kishin çu n'spitalin e Tiranës, kurgjo s'ish bo. Erdhën m'thonë kështu i kem punët me nji t'sëmutë, çka me bo. Thashë, "Birne", e prunën e shtinëm n'spital edhe tash ai, ato u deshke dikush me i ushqy, ai n'shpinë edhe me kthy veç kokën e dikush me ushqye. Ashtu, e prunën, "Ti", thashë, "a ke vlla ma t'madh?" "Jo", "Po motër ma t'madhe?" Tha, "Jo", "A e ki babën t'ri?" Tha, "I fortë osht", thashë, "Qe telefonin. A ka telefon atje?" Ai ishte prej Peje dikah, anës t'Pejës, tha, "E gjojmë me telefon aty që ka", "M'i thonë babës sa ma shpejt me ardhë këtu edhe m'u paraqitë me numër t'telefonit". I erdh baba t'nesërmit. Thashë, "Ti ki me hi në një dhomë me djalin tond edhe m'i shërby djalit. Ka kush i shërben këtu, po sikur ti që i shërben evladit tond, nuk ma merr mendja se mundet me i shërby dikush. Prandaj, këtu me nejtë". "Oh," tha, "po", krevetin n'veti, ushqimin n'veti.

Eh tash mendova unë, ky ka shpenzimet e veta, duhon pijke sende, e shkova te njeni që kishte pare, që punonte, ekonomikisht i fortë. Thashë, "Ti, n'filan vend m'i çu 200 marka n'mujë se e kemi nji t'sëmutë aty edhe e kemi pru babën e tij këtu me u shërby, po ai ka shpenzime". "Ah, s'ka problem", thashë, "Ti vet me i çu, jo mu me m'i dhonë". Se me m'i dhonë mu e mendon a shkunë atje, a ky i shtini n'xhep. Ai e majke n'këtë mënyrë. Domethanë, për çdo gja, për çdo gja, shqiptarët këtu n'Kosovë, këtu n'Turqi kanë kalu si jo ma mirë, si jo ma mirë.

Lura Limani: Kur u kthytë ju n'Prishtinë? A jeni kthy mas luftës?

Enver Tali: Po, n'maj të 2003 jom kthy, se vazhdova unë, e vazhdova, kishte të sëmutë, kishte t'plagosun. Qysh m'i lonë, me ia kthy shpinën? E vazhdova pra deri n'maj të 2003-shit, n'maj të 2003-shit. E lodha edhe djalin. E mshela, e mshela edhe i dorëzova çelësat, u ktheva n'Prishtinë. U ktheva n'Prishtinë po s'u përziva kërkun, jo kërkun s'u përzina (buzëqeshë). E pashë gjatë luftës se aty kishte shumë të tillë që s'kishin ardhë për Kosovën e shpëtimin e shqiptarëve, po kishin ardhë me vu emën edhe m'i shti durtë në xhepa t'hujë. Këto s'ia lejova vetes, s'u shoqnova me ta.

Kur u ktheva n'Prishtinë, para se m'u kthy n'Prishtinë erdh Jakup Krasniqi këtu. Unë s'e kom njoftë, as ai mu jo, po kish ni. Edhe Jakupi m'kërkon, i thonë, "Qe numrin e telefonit t'tijna, thirre". M'thërret Jakupi, telefoni po m'rreh tha, "Unë jom Jakup Krasniqi", unë kisha ni për Jakup Krasniqin. "Po zotni Jakup, kom ni për ju, urdhnoni", tha, "Kom ardhë m'u pa me ty", "Po more", tha, "S'e njoh une Stambollin, s'di kah ia maj". Thashë, "Ku je ti? Unë e di kah ia maj Stambollit," thashë, "vij atje".

M'tregoi hotelin e shkova. Edhe kishte mbrojtësin e vet që e përcillte, edhe ai aty. Ai ma anash rrijke. Tha, "Mu m'kanë çu shokët e tu t'luftës edhe t'jetës edhe na t'konsiderojmë për kuadër tonin". Thashë, "Për cilin kuadër je ka flet?" "Po qe de," tha, "për neve qe". Thashë, "Ju e keni damtu Kosovën, e shqiptarinë aq keq sa që komët s'un i merr mo shqiptaria. Ju keni formu parti të ndryshme, jeni gri vetëvetes... me njoni-tjetrin aq sa Beligradi kishte me dhanë pare t'mëdhaja me na shti n'këto far lloj grindjesh. Prandaj, kush mos t'majë shpresa n'mue. Unë do t'shërbej hala, po do t'i shërbej popullit, jo juve". Ia u pagujta kafetë dhe dola prej atyhit.

Kur u ktheva në Prishtinë, ata kishin marrë nifar iniciative me formu Komunën e Prishtinës. E kishin formu kryetarin, nënkryetarin, i njëfsha. Ai kryetari n'atë kohë, kur unë isha keq me ta, ai ka qenë anëtar i UDB-së, anëtar i UDB-së ka qenë. "Unë," tha, "s'jom marrë me politikë. S'di çka osht' politika", poshtë e naltë e tha, "veç kërkoj ndihmën e ju". Hiç s'i bona zo. Ai nënkryetari që ish bo nënkryetar, vet ata e kanë caktu ato poste. Ai m'njihke, ky u bojke që s'po m'njeh. Tha, "Unë me ty," tha, "e kom lehtë. Ti ki m'u lidhë me neve këtu". P'e kqyri, thashë, "Ti me bisedu me mu kështu, nihere ma s'pari gazetave që kanë shkru për ty", gazetat kanë shkru për to që ka vjedhë. "Atë përgjegje nuk e kanë marrë ata gazetarë, pa i dhonë përgjegje atyne, ti s'munesh me bisedu me mu". Ai... ky që m'foli paska qenë ndihmës kryetari, i treti sekretari. Ai, ato e njëfsha se kishte qenë n'izolimim e dikurshëm me to, njo tre mujë ditë me ni dhomë. Eu burri i mirë, burrë i urtë, e burrë i qetë, me këta që u përzi, thashë, "Ti ke ardhë si muqa mas daieve me këta". E ia nisi me keshë edhe u turpnu që i thashë. Diq, n'rast se dikush e ka njoftë.

Lura Limani: Për fund, kisha pasë qef veç me ju pytë, kur shkutë n'Amerikë edhe me çka merreni tash kryesisht... se për momentin jeni kthy këtu për vizitë t'shkurtë, po a po na tregoni pak kur keni shku n'Amerikë edhe jetën e ju për momentin qysh e keni?

Enver Tali: N'Amerikë, tash jam. Unë kom ardhë për hall, për dert n'Amerikë se unë u smuva atje, morra leukeminë. Leukeminë e dini ju se çka osht'? Edhe, me atë leukemi, e kontrollova veten n'Prishtinë edhe n'Shkup. Shkupi m'tha, "Barna për ty këtu n'Ballkan nuk ka". S'ka barna për mu n'Ballkan, i bona zo djemve se kështu i kom punët. Ata erdhën m'morrën prej ktuhit, m'çunë ashtu n'Amerikë. Ata kanë pagu sigurimet për mue, për mue, edhe pa qenë une aty. Edhe me atë sigurim, m'pranunë n'spitale, m'pranunë n'shërime. Mos t'ishin ata, tash isha harrue. Po tash edhe pse n'tanësi nuk jam i shërumë, ju p'e shifni se pak p'e munoj veten, mirëpo, jam i gjallë. Kështu osht' e shkumja e jeme n'Amerikë.

Edhe meta tash n'Amerikë, kohë mas kohe po m'merr malli për Prishtinë e Kosovë. Edhe ata mjekët po m'japin... kah n'fillim m'kanë dhanë kah nji mujë, tash ma kanë dhanë, ma kanë hypë në gjashtë javë me

ardhë n’Kosovë, po vij edhe po kthehna. Mas gjashtë jave tash, m’duhet m’u kthy përsëri atje. Hi n’terapi, i thojnë ata, edhe terapia pak po m’lodhë masanej po m’lëshon. Kështu po jetoj, n’këtë mënyrë, s’e di sa jom kjartë.

Lura Limani: Po, po.

Enver Tali: N’rast se keni edhe diçka tjetër?

Lura Limani: Falemnderit, kaq e pata. Falemnderit shumë për kohën tuj.

Enver Tali: Me nder e me t’mira.

Lura Limani: Falemnderit shumë që ndatë me neve kaq shumë.

Enver Tali: Jo, s’ka gjo.

Lura Limani: E di që pak je lodhë se kaq gatë me folë, po... jeni mësu ndoshta edhe ju.

Enver Tali: Po, pa u lodhë, s’mrrihet gjo. S’mrrihet gjo...